



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:43 dhe mbaroi në orën 15:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Emona Muçi* (anëtare)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)*
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

5. Klodiana Vogli, përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Përfaqësues të medias.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pezullimin nga detyra të magistrates {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës ë Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen urgjente të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhje e cila ka për shqyrtim pezullimin nga detyra të magistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës ë Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për më shumë detaje, ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Disiplinës, z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën e datës 07.02.2024 është depozituar shkresa nr. {...} prot., të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe ku ka rezultuar se është regjistruar procedimi penal nr. 552, viti 2024, për veprën penale “Kanosja e gjyqtarit” parashikuar nga neni 317 i K.Penal, pas kallëzimit të bërë nga shtetasja, magjistratja {...}, me datë 20.01.2024 pranë Komisarariatit të Policisë nr. 3, Tiranë.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, administrimit të aktit të ekspertimit grafik shkrimi, ka rezultuar se magjistratja {...}, është marrë në cilësinë e të pandehurës nën akuzën e veprave penale “Kallëzim i rremë” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, vepra këto të parashikuara nga nenet 305, 186/1 të K.Penal.

Sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin e datës 07.02.2024 ka vendosur marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës.

E pandehura {...}, aktualisht gëzon statusin e magjistratit dhe ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vlerësimi i rrethanave të faktit në përputhje me parashikimet ligjore.

Bazuar në informacionin e ardhur me shkresën nr. {...} prot., datë 07.02.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton e provuar se:

Magjistratja {...}, me vendimin e datës 07.02.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është marrë në cilësinë e të pandehurës dhe i është njoftuar akuza, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 305, 186/1 të K.Penal, pra tashmë ka marrë cilësinë e të pandehurës.

E pandehura {...}, aktualisht gëzon statusin e magjistrates, pasi ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

E pandehura {...} akuzohet për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 305, 186/1 të K.Penal, duke vënë Këshillin para rastit të pezullimit të detyruar pasi ka marrë cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

Sa më lart parashtruar, arrihet në përfundimin se jemi në një nga rastet e pezullimit të detyruar apo për shkak të ligjit të magjistratit, sipas parashikimeve të nenit 151, pika 1, germa b) të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Për këto arsye, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me funksionin gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Projektvendimin e keni të strukturuar në tre pika.

Pika e parë pra është 1. Pezullimi nga detyra të magjistrates {...}, me funksionin gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magjistrates {...}, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, atëherë unë propozoj që të kalojmë në votim të projekt-aktit.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Naureda Llagami: Markelian!

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e projekt-aktit lidhur me pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor